



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

---

Numri i lëndës: 2022:155708

Datë: 15.10.2024

Numri i dokumentit: 06300774

P.nr.170/22

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA KLINË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Liridona Palushi, në çështjen penale kundër të pandehurve M Gj nga, fsh. L K. Klinë, për shkak të veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, dhe A J nga fsh. R K. Klinë, për shkak të veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-së në Pejë PP/II nr.1448/22, dt.28.07.2021, në bazë të nenit 358 paragraf 1. nën par.1.2 të KPPK-ës, dhe nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim të Kosovës, jashtë shqyrtimit gjyqësorë me dt.15.10.2024, maur këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e arritur në ndërmjetësim nr. Nd. nr.e dt. 27.09.2024 në mes të pandehurve, M Gj dhe A J.

HUDHET AKTAKUZA, PP/II nr.1448/22, dt.28.07.2022, kundër të pandehurve M Gj dhe A J, për shkak të veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së. me arsye se palët ne rastin konkret, në procedurën e ndërmjetësimit kanë arrit marrëveshje dhe pajtim në mes veti me Nd. nr. e dt. 27.09.2024

PUSHOHET procedura penale në çështjen penale PP/II nr.1448/22, dt.28.07.2022, nr., dt.21.09.2021 kundër të pandehurve M Gj dhe A J.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë PP/II nr.1448/22, dt.28.07.2022 ka ngritur aktakuzë, kundër të pandehurit M Gj nga, fsh. L K. Klinë, për shkak të veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, dhe A Jnga fsh. R K. Klinë , për shkak të veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-së. Gjykata me datë 21.07.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ku pas leximit të aktakuzës nga prokurorit të shtetit, palët janë njoftuar për mundësinë e zgjedhjes së kësaj çështje penale përmes procedurës së ndërmjetësimit, ku palët janë pajtuar që kjo çështje të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, prandaj Gjykata lëndën e ka dërguar në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjykata ka dërguar këtë lëndë penale në ndërmjetësim pasi që me neni 2, paragrafi 2, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet në rastet ku parashihet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim deri në tri (3) vjet, përveç rasteve të parapara në paragrafin 3 të këtij neni. Në rastin konkret vepra penale për të cilën është akuzuar i pandehuri është përcaktuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite. Kurse me nenin 8, paragrafi 7, të Ligjit për ndërmjetësim është përcaktuar se pranohet marrëveshja në mes palëve për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, në çdo fazë të procedurës.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së

Gjykata është njoftuar nga ndërmjetësuesi se palët, kanë arritur pajtimin në ndërmjetësim ashtu që janë marr vesh që çështja të zgjidhet përmes ndërmjetësimit, të cilën marrëveshje e kanë nënshkruar dhe e njëjta nga ndërmjetësuesi është proceduar në gjykatë për aprovim të marrëveshjes.

Gjykata vlerëson se me arritjen e marrëveshjes së ndërmjetësimit në mes të pandehurve se është krijuar rrethanë që e pengon ndjekjen penale në kuptim të nenit 358 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, prandaj gjykata edhe ka vendosur si në dispozitiv të pikës 2 dhe 3 të këtij aktvendimi. Gjykata lidhur me shpenzimet e

procedurës penale ka vendosur në bazë të nenit 454 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA KLINË

P.nr 170/2022 dt, 15.10.2024

Gjyqtarja  
Sabrije Rraci

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankese në afat prej tre dite drejtuar gjykatës se Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.